

D. 4. Parlamenti  
Të bashkuar me komitetin  
referencës dhe komitetin  
referencës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I LËVIZJES SOCIALISTE PËR INTEGRIM



Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2018

**Lënda:** Kërkesë për interpelancë urgjente me ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe përfshirja e kësaj interpelance si pikë e parë e rendit të ditës së seancës plenare më të afërt.

**Drejtuar:** KRYETARIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Z. Gramoz Ruçi

Në bazë të nenit 7 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 97 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, kërkojmë këtë interpelancë urgjente me Ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për të dhënë shpjegime mbi implementimin e ligjit nr.80/2015 për Arsimin e Lartë.

Në mënyrë të vazhduar Ministria është thirrur për dëgjese në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, që të raportojë mbi aktet nënligjore të cilat do të duhej të ishin përgatitur për zbatimin e ligjit, por ka refuzuar të marrë pjesë duke shkelur kështu jo vetëm Rregulloren e Kuvendit por edhe Kushtetutën e Shqipërisë.

Në nenin 141 të ligjit "Për Arsimin e Lartë" thuhet qartazi se aktet nënligjore duhet të miratohen brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi të këtij ligji. Sot, dy vite e disa muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit "Për arsimin e lartë", ende nuk kemi gati asnjë akt nënligjor themelor për funksionimin e institucioneve për arsimin e lartë. Shembulli më i qartë i pasojave që vijnë nga kjo papërgjegjshmëri institucionale është mos kalimi në kohë i pagave të petagogëve.

Ministria nuk ka plotësuar detyrimet e saj ligjore për hartimin e strategjisë për arsimin e lartë si edhe për ngritjen e disa institucioneve të reja të parashikuara në ligj. Mos hartimi në kohë i disa prej akteve nënligjore që përgjigjen për funksionimin institucional dhe akademik të IAL-ve, ka krijuar kaos në të gjithë universitetet publike të vendit. Gjithashtu, pavarësisht se kostot e studimeve për familjet shqiptare janë rritur, kreditë studentore nuk mund të merren pasi nuk egzistojnë aktet nënligjore.

Nga ana tjetër disa prej akteve nënligjore që tashmë janë miratuar bien ndesh me frymën e ligjit dhe akoma më keq çenojnë rëndë autonominë e universiteteve.






Lidhur po me implementimin e ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë", një raport i Kontrollit të Lartë të Shtetit për auditimin e performancës së institucioneve përgjegjëse për Maturën Shtetërore 2016, ka gjetur shkelje të rënda të Ministrisë së Arsimit që kanë ndikuar drejtpërdrejt në prishjen e raporteve për pranimin e studentëve në universitete.


KLSH ka konstatuar këto shkelje të cilat përbëjnë indicie të mjaftueshme për institucionet e drejtësisë, për të nisur një procedim penal për Ministren e Arsimit për veprën penale "Shpërdorim detyre" bazuar në nenin 248 të Kodit Penal.

Për sa më sipër, kërkojmë zhvillimin e një interpelance urgjente me Ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Interpelanca në emër të deputetëve që e kërkojnë do të zhvillohet nga deputetja Kejdi Mehmetaj.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

1. Thejdi Mehmetaj 
2. Flajda Kirpaci 
3. Nora Malej 
4. Selva Caka 
5. Robert Bitri 

6. Anwed Krasniulla 
7. Rempar Spah 